



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



DHOMA E AVOKATISË  
E SHQIPËRISË



ALBANIAN  
CHAMBER OF ADVOCACY



## REZOLUTË

# MBI BASHKËPUNIMIN E PROFESIONEVE TË LIRA LIGJORE NË SHQIPËRI

*“SHTYLLA E SUKSESIT PËR SISTEMIN E DREJTËSISË  
DHE  
NEVOJË THELBËSORE PËR QYTETARËT”*

*Ne, përfaqësuesit e profesioneve të lira ligjore, noterët, avokatët, ndërmjetësit,  
dhe përmbaruesit gjyqësorë privatë, të mbledhur në  
Forumin e Profesioneve të Lira të Shqipërisë,*

**Duke njohur rëndësinë kritike të secilit prej profesioneve tona në garantimin e drejtësisë dhe të drejtave të qytetarëve;**

**Duke marrë parasysh sfidat dhe vështirësitë e vazhdueshme me të cilat përballen profesionistët në secilin prej këtyre funksioneve;**

**Duke besuar se një sistem i drejtësisë funksional dhe efikas nuk mund të ekzistojë pa bashkëpunimin e ngushtë dhe të vazhdueshëm mes profesioneve të lira ligjore;**

**Duke synuar që përmes unitetit tonë të forcojmë zërin e përbashkët në mbrojtjen e të drejtave profesionale dhe të interesave të qytetarëve shqiptarë;**

\* \* \* \* \*

**Shpallim dhe angazhohemi:**

- 1. Për të promovuar një bashkëpunim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm** mes të gjitha profesioneve të lira ligjore në Shqipëri me qëllim përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe shërbimit ndaj qytetarëve.
- 2. Për të identifikuar dhe adresuar sfidat e përbashkëta** që përballen profesionistët, të katër profesioneve ligjore në vend, duke përfshirë:
  - Vështirësitë në zbatimin e funksioneve të avokatit, noterit, përmbaruesit dhe ndërmjetësit.
  - Nevojën për respekt dhe mbrojtje të katër profesionistëve nga ndërhyrjet dhe presionet e padrejta.
  - Kritjën e transparencës dhe etikës profesionale nga ushtruesit e këtyre profesioneve.
  - Sigurimin e kushteve të barabarta për ushtrimin e profesioneve reciproke.
- 3. Për të ngritur një platformë të përhershme të dialogut dhe bashkëpunimit** midis përfaqësuesve të profesioneve të lira ligjore, me qëllim diskutimin e vazhdueshëm të problematikave dhe zhvillimin e strategjive të përbashkëta për përmirësimin e sistemit të drejtësisë.
- 4. Për të bashkuar zërin tonë në përfaqësimin publik** për të mbrojtur dinjitetin e profesioneve të lira ligjore dhe për të sensibilizuar opinionin publik

mbi rëndësinë e këtyre profesioneve në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve.

5. **Për të kërkuar nga institucionet shtetërore dhe legjislative politika mbështetëse dhe reforma të qëndrueshme për garantimin e pavarësisë dhe efikasitetit të profesioneve të lira juridike – profesionale në vend.**

\* \* \* \* \*

**Ne besojmë se përmes bashkëpunimit të sinqertë dhe të vendosur, profesionet tona mund të japin një kontribut të rëndësishëm në suksesin e sistemit të drejtësisë dhe mbrojtjen e qytetarëve.**

**Kjo rezolutë miratohet në këtë forum, si akt i parë referuar Memorandumit të Bashkëpunimit nënshkruar mes Dhomave tona, me qëllim zbatimin praktik të tij, përmes veprimeve konkrete dhe të koordinuara nga të gjitha palët e përfshira.**

***FORUMI I PROFESIONEVE TË LIRA LIGJORE TË SHQIPËRISË***

***Tiranë, datë 23.12.2024***